

REGJISTËR KËRKESASH PËR PERIUDHËN 01.10.2025-31.10.2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	30.09.2025	Emision Stop kerkon informacion ne lidhje me titullin Akademik Profesor Doktor i shtetases Elvira Fetahu , i dhene ne vitin 2024. Komisioni qe ka dhene kete titull ka kontrolluar titujt e meparshem dhe ligjitimitetin e tyre? A i plotesonte kriteret zonja Fetahu per kete titull?	03.10.2025	E nderuar Znj. Bajraktari Në përgjigje të kërkesës Tuaj dërguar në adresën e email-it të UBT-së, lidhur me “Kontrollin e titujve të mëparshëm dhe legjitimitetin e tyre”, për Prof. Dr. Elvira Fetahu, sqarojmë se në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM-ve përkatëse, procedura parashikon vetëm plotësimin e kriterëve, legjitimitetin e dokumentacionit dhe vlerësimin e aftësive të kandidatit për titullin akademik, për të cilin ka aplikuar në UBT, në këtë rast, për titullin “Profesor”. Ju bëjmë me dije se znj. Fetahu, gradën shkencore “Doktor” dhe titullin akademik “Profesor i Asociuar” nuk i ka marrë në UBT. Rrjedhimisht, ne nuk kemi detyrim ligjor për të verifikuar diplomat, gradat apo titullin e mëparshëm. Ju faleminderit!	E plotë	Nuk ka